



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr.1019 Prot.

Tiranë, më 28 .05 . 2026

V E N D I M

Nr. 139, Datë 28.05. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr.232 regj, datë 14.10.2025, paraqitur nga ankuesi D.Gj kundër Bashkisë Shkodër, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese shpjegon sa më poshtë:

“Unë, D.Gj , kam filluar punë si inspektor rajoni në lagjen nr.2, Shkodër, fillimisht me një kontratë 1 vjeçare prove. Pas përfundimit të periudhës së provës, u thirra për të marrë statusin e nëpunësit civil pranë ASPA-s. Pas përfundimit të trajnimit dhe dhënies së provimit, fitova statusin e punonjësit civil.

Megjithatë, pas vetëm 3-4 muajsh, kryetari i rajonit paraqiti një urdhër për ristrukturimin e strukturës, ku parashikohej shkurtimi i një vendi pune. Pa asnjë vërejtje dhe pa asnjë vlerësim negativ ndaj meje, u vendos që unë të hiqesha nga puna. Vendimi u mor pa kaluar fare në komisionin disiplinor, siç e parashikon ligji, dhe unë u njoftova vetëm përmes një zarfi ku ishte shkresa për shkarkimin tim të menjëhershëm. Gjithashtu, procedura ligjore për përfundimin e procesit të emërimit tim si punonjës civil nuk u respektua plotësisht, pasi kryetari nuk firmosi dokumentin për konfirmimin e statusit tim.

Para shkarkimit, Kryetari më ka pyetur vazhdimisht lidhur me angazhimin tim politik, duke qenë se unë jam anëtar i Partisë Demokratike, Dega Shkodër, ku kam ushtruar disa funksione si, Kryetar

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Seksioni, Kryetar i Qendrës së Votimit Nr. 282 në Kopshtin Soros, Kryetar Komisioni dhe numërues në Qendrën e Votimit në Shkollën “Shejnaz Juka”. Këto rrethana tregojnë qartë se shkarkimi im është bërë për arsye politike dhe përbën diskriminim mbi bazën e bindjeve politike, në kundërshtim me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Dua të theksoj gjithashtu se, gjatë vitit të provës, kur u zhvilluan zgjedhjet vendore të vitit 2023, nuk kam ushtruar asnjë aktivitet politik deri në ditën e votimit. Për këtë arsye, kërkoj të konstatohet se shkarkimi im është i padrejtë dhe diskriminues, të urdhërohet kthimi im në detyrë në pozicionin përkatës ose një pozicion të barabartë në shërbimin civil, si dhe të më jepet kompensim financiar për periudhën që kam mbetur pa punë padrejtësisht.”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD-së, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1 të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i LMD-së, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në Kreun II, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/c, parashikon shprehimisht: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; “, duke ndaluar çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike, që i bëhet punëmarrësit në gëzimin e të drejtës për punësim.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7 të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 32 e 33 të LMD-së Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me *emailin* e datës 03.11.2025, palës ankuese i është kërkuar plotësimi i ankesës me informacionin dhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Aktin për përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil, të nxjerrë nga punëdhënësi/Bashkia Shkodër.
 - Dokumentacionin që provon angazhimin politik dhe mbajtjen e funksioneve në forcën politike/Partia Demokratike.
 - Kopje të kërkesë padisë (të plotë) të paraqitur para Gjykatës në lidhje me largimin nga puna.
 - Praktikën në lidhje me pretendimin e ngritur sa i takon refuzimit për të firmosur dokumentin për konfirmimin e statusit të nëpunësit civil.

Ankuesi plotësoi ankesën me *e-mailin* e datës 05.11.2025.

2. Pas plotësimit të ankesës, me shkresën nr.1441/1 prot datë 07.11.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Shkodër në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
3. Me shkresën 23734 prot., datë 17.11.2025, ka kthyer përgjigje Bashkia Shkodër, duke parashtruar ndër të tjera:

“Në zbatim të vendimit nr.34, datë 29.12.2023 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Shkodër “Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar; dhe “Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12, datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 55, datë 29.12.2023 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Shkodër “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” dhe të vendimit nr.30, datë 24.01.2024 “Për miratimin e strukturës të punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të bashkisë Shkodër”, në vitin 2024 Bashkia Shkodër ka realizuar procesin e ristrukturimit.

Për realizimin e procesit të transferimit të nëpunësve civilë, punonjësve administrativë dhe mbështetës, punonjësve të arsimit parashkollor (edukator) si rezultat i zbatimit të pikës 3, të VKB nr.54, datë 29.12.2023 dhe vendimit nr.30 datë 24.01.2024 “Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër”, u hartua urdhri nr.112 datë 31.01.2024 “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit” për nëpunësit civilë, pozicionet e të cilëve preken ose suprimohen nga ristrukturimi..

Komisioni i ristrukturimit duke analizuar pozicionet e punës të pasqyruara në vendimin nr.30 datë 24.01.2024 ka konstatuar se në pozicionet e nëpunësve civilë në administratën e Bashkisë Shkodër, janë suprimuar 39 vende në kategorinë ekzekutive (specialist) dhe 18 vende në kategorinë e ulët drejtuese (përgjegjës).

Referuar pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, akteve nënligjore në zbatim të tij, pikës 3, të VKB nr.54, datë 29.12.2023, kritereve të secilit nëpunës civil, të cilit i suprimohet vendi i punës, Komisioni i ka propozuar DBNJ sistemimin e 38 nëpunësve civil me transferim të përkohshëm dhe/ose të përhershëm, si dhe përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të 18 nëpunësve civil për shkak të pamundësisë së transferimit të tyre.

Për shkak të ristrukturimit, numri i pozicioneve të punës në njësinë ku ka ushtruar punën z.D.Gj është suprimuar nga 4 punonjës në 3 punonjës. Në zbatim të detyrimeve ligjore të përlllogaritjes së dhënies së shpërblimeve për vjetërsi pune, duke iu referuar edhe statusit të punësimit të z.D.Gj , rezulton se kohëzgjatja e marrëdhënies së punës së tij me Bashkinë Shkodër, është 1 (një) vit pune.

Bazuar në pikën 7, të nenit 50 të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar z.D.Gj është njoftuar për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil 1 (një) muaj përpara, brenda afatit ligjor të njoftimit.

Ndërsa bazuar në nenin 143 dhe 145 të ligjit nr.7961/1995, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, z.Gj. nuk ka përfutuar shpërblimin për vjetërsi të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës pasi periudha e punësimit në Bashkinë Shkodër është më pak se tre vite.

Komisioni i Ristrukturimit për transferimin e përkohshëm dhe/ose të përhershëm, si dhe përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të nëpunësve civilë është mbështetur në kriteret si më poshtë:

- *Arsimi*
- *Përshkrimi i punës.*
- *Eksperiencë pune në pozicionin aktual.*
- *Vjetërsi në punë.*
- *Performanca në punë/vlerësimi i eprorit.*

Për palën ankuese z.D.Gj , rezulton si vijon:

- *Arsimi i lartë në fushën e edukimit fizik.*

- *Eksperiencë pune në pozicionin aktual 1 vit pune.*
- *Vjetërsi pune 1 vit pune.*

Numri total i pozicioneve të punës inspektor në lagjen nr.2, në Bashkinë Shkodër, ka qenë 3 pozicione dhe numri total i pozicioneve të punës inspektor lagjeje në të gjithë Bashkinë Shkodër ka qenë 14 pozicione.

Numri i punonjësve që kanë mbajtur pozicionin e punës inspektor që janë larguar përfundimisht nga puna si pasojë e ristrukturimit është 3 punonjës dhe numri i punonjësve që kanë mbajtur pozicionin e punës inspektor dhe kanë vijuar dhe vijojnë marrëdhënien e punës në të njëjtin pozicion është 11 punonjës.

Numri aktual i pozicioneve të punës inspektor në lagjen nr.2 në Bashkinë Shkodër, është 2 pozicione dhe numri total i pozicioneve të punës inspektor lagjeje në të gjithë Shkodrën është 11 pozicione.

Nuk kemi aktualisht pozicione të lira pune në pozicionin inspektor lagjeje në Bashkinë Shkodër.

Në lidhje me pretendimin e palës ankuese, referuar kërkesë padisë së paraqitur në gjykatë, bazuar në nenin 36, të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, kërkojmë përfundimin e shqyrtimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.”

4. Me e-mailin e datës 20.11.2025, palës ankuese i është vendosur në dispozicion përgjigja e Bashkisë Shkodër. Pala ankuese nuk ka depozituar prapësime.
5. Bazuar në nenin 33/8, të LMD-së, ku parashikohet: “8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.” si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore.

Me shkresën nr. 1825 prot., datë 29.12.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 14.01.2026. Kjo seancë dëgjimore nuk u zhvillua për shkak se pala ankuese njoftoi se ishte në pamundësi për të marrë pjesë. Në këto kushte, për t’i dhënë mundësinë palëve për të marrë pjesë në seancë, Komisioneri vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore.

Me shkresën nr. 194 prot., datë 22.01.2026, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 20.02.2026.

Seanca dëgjimore e datës 20.02.2026 u zhvillua me pjesëmarrjen e të dy palëve, ankuesit D.Gj , i cili u paraqit personalisht dhe Bashkisë Shkodër, përfaqësuar nga znj. R.Rr, me detyrë Specialiste, pranë Drejtorisë Juridike në Bashkinë Shkodër, e pajisur me autorizimin nr.4006 prot., datë 20.02.2026, lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër.

6. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr.5687 prot., datë 10.03.2026, Bashkia Shkodër, depozitoi informacion shtesë, duke parashtruar ndër të tjera:

Z.Gj. nuk është konfirmuar në detyrë si nëpunës civil, pra nuk ka status nëpunësi civil, duke qenë se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative dy kushtet e konfirmimit të statusit të nëpunësit civil për personat në periudhë prove, konform përcaktimeve të nenit 24, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 2.6 dhe 7, të Kreut VI, të Vendimit nr.243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, këtu:

1. Zhvillimi me sukses i trajnimit të detyrueshëm nga ASPA

2. Vendimi i konfirmimit nga ana e eprorit në përfundim të vlerësimit të punonjësit për periudhën 1 vjeçare nga data e aktit të emërimit.

Z.Gj. ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm “Prezantimi me Administratën Publike” nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në periudhën 25 tetor – 6 nëntor 2023, ndërkaq nuk është realizuar kushti i dytë për marrjen e statusit të shërbimit civil, pra “Vendimi i konfirmimit nga ana e eprorit në përfundim të vlerësimit të punonjësit për periudhën 1 vjeçare nga data e aktit të emërimit.

Sa i takon procedurës të ndjekur për shkëputjen e marrëdhënies së punës me z.Gj. , janë zbatuar rregullimet specifike të legjislacionit për shërbimin civil pavarësisht se ky subjekt nuk ka qenë nëpunës civil i konfirmuar, duke qenë se procedura e rekrutimit, pra e lidhjes së marrëdhënies së punës me z.Gj. është bërë sipas legjislacionit për shërbimin civil. Pra, z.Gj. ka qenë në marrëdhënie pune në shërbimin civil, i emëruar si nëpunës civil.

Në momentin e ristrukturimit të institucionit, ka pasur edhe punonjës të tjerë të rekrutuar në shërbimin civil, në periudhë prove, marrëdhënia e punës e të cilëve ka vijuar pasi struktura ku kanë qenë të emëruar nuk është prekur nga ristrukturimi.

Bashkia Shkodër kërkon nga ana e Komisionerit që të pezullojë shqyrtimin e ankesës së ankuesit D.Gj , bazuar në nenin 36, paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative.

- *Në lidhje me kërkesat e Bashkisë Shkodër për pezullimin e shqyrtimit të ankesës dhe mbylljen e shqyrtimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, pasi mosmarrëveshja është zgjidhur përfundimisht nga Gjykata*

Fillimisht Bashkia Shkodër kërkoi përfundimin e shqyrtimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, pasi mosmarrëveshja ishte bërë objekt shqyrtimi, para Gjykatës. Këtë kërkim Bashkia Shkodër e mbështet në parashikimet e nenit 36, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Civile.

Në vijim, Bashkia Shkodër, duke referuar njëkohësisht edhe tek 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, ka kërkuar pezullimin e shqyrtimit të ankesës objekt shqyrtimi nga ana e Komisionerit, bazuar në nenin 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 36, paragrafi 3, Kodi i Procedurës Civile, përcakton:

“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”

Neni 66, pika 1, Kodi i Procedurave Administrative, parashikon:

“1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”

Neni 33 “Procedurat”, të LMD, përcakton:

“7/4. Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”

Në bazë të akteve të administruara rezulton se, ankuesi ka depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë një kërkesë padi me objekt: *“1. Shfuqizimin e vendimit “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit, me z.D.Gj , me detyrë Inspektor, Lagjia nr.2”, me nr.4250 prot., datë 28.02.2024, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Bashkia Shkodër. 2. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Shkodër për të rikthyer paditësin D.Gj në shërbimin civil, në vendin e tij të mëparshëm ose në një pozicion tjetër të barazvlefshëm me të. 3. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë palës paditëse pagën që nga momenti i largimit nga detyra deri në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi.”*

Rezulton se, me vendimin nr.80-2025-4948, datë 29.12.2025, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së paraqitur nga ankuesi.

LMD, ka parashikuar në nenin 34, pika 1, të tij se, çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente, ndërsa bazuar në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se, paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesë padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës.

Në vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, Gjykata e Lartë shprehet se: *“...një fakt i caktuar mund të sjellë lindjen e shumë marrëdhënive juridike të njëkohshme apo të njëpasnjëshme.*

Marrëdhëniet juridike në fjalë qëndrojnë në themel të shkakut të padive respektive që mund të ngrihen nga subjektet pjesëmarrëse të këtyre marrëdhënieve juridike. Objekti i padisë ose kërkimi që i kundërdrejtohet palës kundërshtare mund të jetë i njëjtë në disa padi, por ato dallojnë nga njëra-tjetra sepse bazohen në shkaqe të ndryshme juridike.”

Në referim të vendimit unifikues nr.3/2012, objekti i padisë (*petitum*) është ajo që kërkohet nëpërmjet paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë dhe, që ka të bëjë me vendimmarrjen që i kërkohet gjykatës duke përmbledhur në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Nga ana tjetër, shkakun e padisë është kombinimi i faktit cenus dhe i së drejtës subjektive mbi të cilën bazohet padia e që ka lidhje me marrëdhënien juridike që është themeli i pretendimit të paraqitur me kërkesëpadi në gjykatë. Rjedhimisht, shkakun e padisë identifikohet duke e parë të lidhur me faktet e pretenduara që kanë cenuar të drejtën subjektive apo interesat e ligjshme të paditësit. Shkakun e padisë përbëhet nga dy elementë: 1) e drejta subjektive, e cila gjen burimin e saj tek e drejta objektive dhe 2) gjendja e faktit kundër kësaj të drejte (*causa petendi*). Për të kuptuar shkakun e padisë ndihmon edhe silogjizmi se norma juridike përbën premisën e madhe (parashikimin abstrakt të fakteve), faktet konkrete individuale përbëjnë premisën e vogël dhe lidhja midis këtyre të dyjave përbën marrëdhënien juridike nga ku rrjedh shkakun e padisë.

Nga aktet e administruara nuk rezulton që ankuesi të ketë paraqitur në kërkesë padinë para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkime me objekt konstatimin e diskriminimit. Kërkesë padia që ankuesi ka paraqitur para Gjykatës ka objekt dhe shkak tjetër ligjor nga ankesa objekt shqyrtimi e paraqitur pranë Komisionerit. Pra, ankuesi ka zgjedhur që të mos pretendojë para Gjykatës kërkimin për diskriminim që ka paraqitur për trajtim para Komisionerit në këtë ankesë. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se çështja që ankuesi ka paraqitur para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe çështja objekt shqyrtimi pranë Komisionerit nuk kanë mbivendosje dhe rrjedhimisht nuk ka asnjë pengesë ligjore për shqyrtimin e saj, sipas nenit 33, pika 7/4 të LMD dhe nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 33, pika 7/4, të LMD dhe neni 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, nuk kanë të bëjë me kërkime që lidhen me pezullimin e shqyrtimit të çështjes para Komisionerit, por këto dispozita përbëjnë një kufizim të kompetencës së Komisionerit si një organ administrativ për të marrë në shqyrtim çështje me pretendim diskriminimi e cila është bërë objekt shqyrtimi nga ana e Gjykatës.

Për sa i përket kërkimit të Bashkisë Shkodër për pezullimin e shqyrtimit të ankesës, duke referuar tek neni 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri e vlerëson këtë kërkim të pabazuar.

Neni 66, pika 1, i Kodit të Procedurave Administrative (KPA) parashikon se organi publik pezullon procedurën kur përmbushen kumulativisht dy kushte: (i) zgjidhja e çështjes paraprake të jetë parakusht për zgjidhjen e procedurës administrative dhe (ii) çështja paraprake të jetë kompetencë ekskluzive e një gjykate ose organi tjetër. Në rastin konkret, asnjëri nga këto kushte nuk plotësohet.

Së pari, objekti i dy çështjeve është i ndryshëm. Kërkesëpadia e paraqitur nga ankuesi para Gjykatës ka si objekt shfuqizimin e aktit administrativ të largimit nga puna dhe rikthimin në detyrë, pra, një mosmarrëveshje e së drejtës së shërbimit civil që vlerëson ligjshmërinë e vendimit të ristrukturimit. Ankesa para Komisionerit ka objekt të ndryshëm, konkretisht konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, pra, vlerëson motivin dhe efektin diskriminues.

Së dyti, vendimi gjyqësor nuk është “parakusht” për vendimmarrjen e Komisionerit. Çështja paraprake në kuptimin e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative ekziston vetëm kur zgjidhja e procedurës administrative është e pamundur pa u zgjidhur së pari çështja tjetër. Komisioneri mund të vlerësojë nëse ka pasur diskriminim për shkak të bindjeve politike pa qenë i lidhur me gjetjet e gjykatës. Gjykata nuk ka shqyrtuar pretendimin e diskriminimit, ndaj vendimi i saj nuk zgjidh çështjen objekt ankese.

Qëllimi i institutit të pezullimit është shmangja e vendimeve të papajtueshme ndërmjet organit administrativ dhe gjykatës. Ky qëllim mund të realizohet vetëm nëse çështja paraprake ka lidhje me objektin e procedurës administrative. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 80-2025-4948, datë 29.12.2025, ka zgjidhur një mosmarrëveshje të ndryshme, ligjshmërinë e aktit të ristrukturimit dhe nuk ka shqyrtuar pretendimin e diskriminimit, objekt shqyrtimi nga Komisioneri në ankesën objekt shqyrtimi.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se ankuesi D.Gj , ka qenë nëpunës civil, në pozicionin Inspektor, Lagjia nr.2, Bashkia Shkodër. Ai është emëruar në këtë pozicion pune bazuar në aktin e emërimit nr.8, datë 01.02.2023, si nëpunës civil në periudhë prove.

Rezulton se, ankuesi ka kaluar me sukses testimin në kursin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove “*Prezantimi me Administratën Publike*”, organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, në periudhën 25 tetor – 06 nëntor 2023.

Me vendimin nr.54, datë 29.12.2023, të Këshillit Bashkiak Shkodër “*Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar dhe “Për një ndryshim dhe shtesë në VKV nr.12, datë 20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar*”, Bashkia Shkodër ka pësuar ndryshime strukturore të cilat kanë sjellë shkrirjen e disa institucioneve dhe krijimin e institucioneve të reja.

Në vijim të VKB së sipërcituar, me vendimin nr.30, datë 24.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër është miratuar struktura e re e nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër.

Me urdhrin nr.112, datë 31.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër është krijuar Komisioni i Ristrukturimit, i cili do të realizojë procedurat përkatëse në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies së punës për nëpunësit civilë që i nënshtrohen procesit të ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit i krijuar me urdhrin nr.112, datë 31.01.2024, ka pasqyruar vlerësimet e kryera në procesverbalin me nr.1985 prot., datë 31.01.2024. Referuar përmbajtjes së këtij procesverbali, Komisioni i Ristrukturimit për sistemimin/shkurtimin e pozicionit të punës të nëpunësve civilë është mbështetur në këto kritere: arsimimi; përshkrimi i punës; eksperiencia në punë në pozicionin aktual; vjetërsia në punë; performanca në punë/vlerësimi i eprorit.

Në përfundim të shqyrtimit të dosjeve të nëpunësve dhe mundësisë së sistemimit/shkurtimit të pozicioneve të punës të nëpunësve civilë, Komisioni i Ristrukturimit i ka propozuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e Njësisë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Shkodër, listën emërore të punonjësve që sistemohen në kuadër të ristrukturimit dhe listën emërore të punonjësve pozicionet e të cilëve shkurtohen në kuadër të ristrukturimit. Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar përfundimin e marrëdhënies së punës me ankuesin D.Gj .

Me shkresën nr. 2111 prot., datë 01.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, ankuesi është njoftuar për fillimin e procedurave për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pasi në kuadër të procesit të ristrukturimit të institucionit pozicioni i punës i ankuesit “Inspektor, Lagjia nr.2”, në Bashkinë Shkodër është mbyllur.

Me shkresën nr.4250 prot., datë 28.02.2024, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Shkodër, ankuesi është liruar nga shërbimi civil, me motivacionin “për shkak të ristrukturimit të institucionit”.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar nga Bashkia Shkodër për shkak të bindjeve politike, pasi ai është anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike, bindje këto të kundërta me Kryetarin e Bashkisë Shkodër. Pretendimi i parë i ankuesit lidhet me moskonfirmimin e tij në detyrë si nëpunës civil, ndërsa pretendimi i dytë ka të bëjë me momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave*

e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të LMD, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se diskriminimi ka ndodhur, duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme.
- në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, dhe;
- arsyeja për këtë trajtim është një/disa nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi.

Pra, për të provuar sjelljen diskriminuese, para së gjithash, duhet të provohet se pala ankuese është trajtuar ndryshe dhe në mënyrë të disfavorshme nga një person ose grup personash të vendosur në një situatë të njëjtë ose të ngjashme. Personi ose grupi tjetër i personave me të cilin krahasohet aplikanti quhet "*krahasues*".

- *Në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil*

Referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi, rezulton se, marrëdhënia e punës në shërbimin civil, sikundër është marrëdhënia e punësimit që ankuesi ka pasur me punëdhënësin/ Bashkia Shkodër rregullohet në bazë të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Nga aktet e administruara rezulton e provuar se Bashkia Shkodër i është nënshtruar procesit të ristrukturimit.

Ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil duke u liruar nga shërbimi civil, për shkak të mbylljes së pozicionit të tij të punës "*Inspektor Lagja nr.2*", në Bashkinë Shkodër.

Sipas nenit 50 "*Transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*", të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*" të ndryshuar, parashikohet se, përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së një institucioni, nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur, si pasojë e këtyre procedurave, ka shkurtrim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe transferimi, sipas pikës 2 të këtij neni, është i pamundur.

Sipas strukturës së re të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendimin nr.30, datë 24.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, konstatohet se në total janë suprimuar 40 (dyzetë) pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) pozicione pune që i përkasin kategorisë drejtuese. Nga aktet konstatohet se, me strukturën e re është suprimuar 1 (një) pozicion pune “inspektor lagje nr.2”.

Nga krahasimi i strukturës së re të vitit 2024, të miratuar sipas vendimit nr.30, datë 24.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër me strukturën e vitit 2023, të miratuar sipas vendimit nr.213, datë 28.07.2023, konstatohet se numri total i pozicioneve të punës “inspektor lagje nr.2”, ka qenë 3 (tre), sipas strukturës së vitit 2023 dhe është bërë 2 (dy), sipas strukturës së vitit 2024.

Nga krahasimi i dy strukturave, asaj të vitit 2023 dhe 2024, konstatohet se, janë suprimuar edhe pozicione të tjera pune “inspektor” në lagjet e tjera të Bashkisë Shkodër. Konkretisht, nga 2 (dy) pozicione pune “inspektor lagje” që kanë qenë respektivisht për lagjen nr. 3 dhe lagjen nr.4 sipas strukturës së vitit 2023, është bërë nga 1 (një) pozicion pune “inspektor lagje”, respektivisht për secilën nga këto lagje, sipas strukturës së re të vitit 2024.

Nga krahasimi i dy strukturave, të vitit 2023 dhe 2024, konstatohet se nga 12 (dymbëdhjetë) pozicione pune “inspektor lagje” sipas strukturës së vjetër të vitit 2023, me strukturën e re të vitit 2024, pozicionet e punës “inspektor lagje” bëhen 9 (nëntë). Në këtë mënyrë, me strukturën e re të vitit 2024 janë suprimuar 3 (tre) pozicione pune “inspektor lagje”

Nga krahasimi i dosjeve të nëpunësve civilë të cilët kanë qenë të punësuar në pozicionet e punës “inspektor lagje nr.2”, konstatohet se, ankuesi është punonjësi i cili ka pasur më pak eksperiencë pune në pozicionin aktual dhe më pak vjetërsi në punë. Nga aktet rezulton se:

- Ankuesi D.Gj , ka eksperiencë pune në pozicion 1 (një) vit punë dhe vjetërsi në punë 1 (një) vit punë.
- Punonjësja T.T, ka eksperiencë pune në pozicion dhe vjetërsi në punë rreth 8 (tetë) vite (emëruar si nëpunëse civile në vitin 2016 dhe konfirmuar në vitin 2018)
- Punonjësi O.M, ka një eksperiencë pune në pozicion dhe vjetërsi në punë rreth 5 (pesë) vite (emëruar si nëpunës civil në vitin 2019 dhe konfirmuar si nëpunës civil në vitin 2020).

Referuar kritereve të vlerësimit ku është bazuar vlerësimi i Komisionit të Ristrukturimit dhe akteve të administruara, rezulton se, ankuesi ka qenë nëpunësi civil me më pak eksperiencë pune jo vetëm në pozicion “inspektor lagje” por edhe punonjësi me më pak vjetërsi në punë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, vendimmarrja e Komisionit të Ristrukturimit për të vijuar marrëdhënien e punës në shërbimin civil me dy punonjësit e tjerë dhe jo me ankuesin, në kushtet kur është shkurtuar numri i pozicione të punës “inspektor lagje nr.2” nga 3 inspektorë në 2, është e bazuar, pasi këta punonjës kanë më shumë eksperiencë pune në pozicion dhe më shumë vjetërsi në punë, se ankuesi.

Nga aktet e administruara rezulton se, ka patur një shkurtim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe gjithashtu një shkurtim të të gjithë pozicioneve të punës “inspektor lagje” edhe në njësitë e tjera të Bashkisë Shkodër.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, rezulton se transferimi i ankuesit në një pozicion tjetër në shërbimin civil ka qenë i pamundur. Në këto kushte, përfundimi i marrëdhënieve të punës në shërbimin civil me ankuesin, për shkak të suprimimit të pozicionit të punës si pasojë e ristrukturimit, nuk vjen në kundërshtim me nenin 50, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi D.Gj nuk i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe të disfavorshëm nga ana e Bashkisë Shkodër, në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil dhe lirim të tij nga pozicioni i punës “inspektor lagje nr.2”.

- Në lidhje me pretendimin për moskonfirmimin e ankuesit në detyrë si nëpunës civil

Neni 24 “Periudha e provës”, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshua, parashikon:

“1. Nëpunësi, që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

2. Gjatë periudhës së provës nëpunësi kryen ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe kryen detyrat nën kujdesin e një nëpunësi të vjetër civil të së njëjtës kategori ose kategorie më të lartë.

3. Në fund të periudhës së provës, institucioni, ku nëpunësi është i emëruar, vendos:

a) konfirmimin e nëpunësit;

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuar ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit;

c) moskonfirmimin e nëpunësit.

4. Vendimi, sipas pikës 3 të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale në punë dhe në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s.

5. Këshilli i Ministrave përcakton detyrimet e nëpunësit civil në periudhë prove, si dhe kriteret e procedurën e vendimmarrjes, sipas pikës 3 të këtij neni.”

Në Kreun VI, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, parashikohet:

“KREU VI

PERIUDHA E PROVËS

1. Nëpunësi, që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

2. Gjatë periudhës së provës nëpunësi është i detyruar të ndjekë:

a) programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s;

b) udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

3. Nëpunësi më i vjetër civil përzgjidhet nëpunësi, i cili ka vjetërsinë më të madhe në detyrë dhe që bën pjesë në të njëjtën njësi organizative ku është emëruar nëpunësi në periudhë prove.

4. Nëpunësi më i vjetër civil duhet të jetë i së njëjtës kategori ose i një kategorie më të lartë dhe caktohet nga eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove.

5. Eprori direkt, në rast largimi apo pamundësie të ushtrimit të detyrës nga nëpunësi më i vjetër në detyrë, merr masa për zëvendësimin e tij me nëpunësin e dytë më të vjetër në detyrë brenda së njëjtës njësi organizative.

6. Vendimi në përfundim të periudhës së provës merret bazuar në:

a) rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA;

b) vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore.

7. Bazuar në vlerësimet sipas pikës 6 të kreut VI të këtij vendimi, dhe pas marrjes së mendimit me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, i përcaktuar sipas pikave 3, 4 dhe 5 të kreut VI të këtij vendimi, eprori direkt është i detyruar të vendosë:

a) Konfirmimin e nëpunësit civil, nëse ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe është vlerësuar të paktën “kënaqshëm”;

b) Zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së provës, në rast të mospërfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm në ASPA, pamundësisë së vlerëimit të plotë të nëpunësit, në rast se eprorit i nevojitet më shumë kohë për të vlerësuar nëpunësin, në rastet e mungesës në detyrë të nëpunësit për shkak të trajnimit afatgjatë, raportit mjekësor afatgjatë dhe në raste të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të cilat rregullojnë mungesën në detyrë të nëpunësit;

c) Moskonfirmimin e nëpunësit civil. Në këtë rast nëpunësi lirohet nga shërbimi civil.

.....”

Sa më sipër rezulton se, konfirmimi në detyrë si nëpunës civil kryhet në përfundim të periudhës së provës, e cila është 1 vit nga data e emërimit. Konfirmimi në detyrë i nëpunësit civil, në përfundim të periudhës së provës, realizohet nëse përmbushen dy kushte: në radhë të parë nëse nëpunësi civil në periudhë prove ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe në radhë të dytë nëse është vlerësuar të paktën “kënaqshëm”.

Nga aktet e administruara rezulton e provuar se ankuesi është emëruar si nëpunës civil në periudhë prove në datën 01.02.2023. Në këto kushte periudha e provës për ankuesin përfundonte në datën 01.02.2024.

Sipas strukturës së re të vitit 2024, të miratuar me vendimin nr.30, datë 24.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, numri i pozicioneve të punës “inspektor” në lagjen nr.2, është shkurtuar nga 3 në 2. Në datën 31.01.2024, Komisioni i Ristrukturimit me të drejtë ka vlerësuar dhe ka propozuar se, nga 3 punonjësit e punësuar në pozicionet e punës “inspektor në lagjen nr.2”, ankuesi duhet të

ishite punonjësi me të cilin nuk duhej të vijohej marrëdhënia e punës në shërbimin civil në pozicionin “inspektor lagje nr.2”, për shkak të mbylljes së pozicionit të punës.

Në këto kushte dhe kur deri në datën 31.01.2024, nuk ishte plotësuar afati 1 vjeçar i periudhës së provës i parashikuar nga neni 24, i ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur pozicioni i punës ku ankuesi ishte emëruar si nëpunës civil në periudhë prove, ishte suprimuar dhe nuk ekzistonte më dhe se me të drejtë është vlerësuar që marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil të vijojë me dy punonjësit e tjerë, të cilët kishin më shumë eksperiencë në pozicionin e punës dhe më shumë vjetërsi në punë, Komisioneri arrin në përfundimin se, punëdhënësi/Bashkia Shkodër nuk mund të vijonte me procedurën për konfirmimin në detyrë si nëpunës civil të ankuesit, për një pozicion që sipas strukturës në fuqi nuk ekzistonte.

Përfundimisht, bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi D.Gj nuk i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe më pak të favorshëm nga ana e Bashkisë Shkodër, në lidhje me moskonfirmimin në detyrë si nëpunës civil në pozicionin “inspektor lagje nr.2”.

Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e Bashkisë Shkodër ndaj ankuesit D.Gj , në lidhje me të dy pretendimet objekt i ankesës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit D.Gj nga ana e Bashkisë Shkodër, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)

Shkaku: Bindje politike
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim